Z-KM101

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana | 31.08.2017 god. | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i org. njës. Org.jed. | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02 | 035/02-814 | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 2008/28, nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, nenit 5 paragrafi 4 të Rregullores për ndarjen subvencioneve nr. 01-013/1706 të datës 23.12.2016, Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë shqyrtoi kërkesën e Shoqatës së Pensionistëve të Komunës së Vitisë dhe lidhur me këtë morri këtë:

# VENDIM

## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ **400,00€** SHOQATËS SË PENSIONISTËVE TË KOMUNËS SË VITISË

**I.**

Kryetari i Komunës së Vitisë I **NDAN** ndihmë financiare në shumë prej **400,00** (katërqind euro ), Shoqatës së Pensionistëve të Komunës së Vitisë në emër të mbështetjes financiare për kryerjen e aktiviteteve të kësaj shoqate.

**II.**

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017 nga kodi buxhetor për subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës së Vitisë.
Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Shoqatës së Pensionistëve në Viti.

**III.**

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë.

**IV.**

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË
Sokol Haliti

Viti, më 29.08.2017.

Vendimi u dorëzohet:

1. Xhemajl Rrustemi - Kryetarit të shoqatës
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi